



ZRRUK/UTSH-06/08/2014  
31 Dhjetor 2013

Në pajtim me autoritetin e dhënë me *Ligjin Nr. 03/L-086, mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit* të datës 15 qershor 2008 me të cilën është amendamentuar *Rregullorja 2004/49 ("Ligji")*

Konform Nenit 15 të *Rregullës për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë* të datës 24 dhjetor 2012 (Rregulla - ZRRUK R 02/U&K),

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të dorëzuara nga NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë, dhe në procesin e zhvilluar të analizave dhe të vlerësimit të tyre,

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizime ("ZRRUK") lëshon këtë:

## URDHËRESË TE TARIFAVE TË SHËRBIMIT

### PËR PËRCAKTIM TË TARIFAVE PËR FURNIZIM TË UJIT ME SHUMICË TË PA TRAJTUAR QË DUHET TË APLIKOHEN NGA NH "IBËR-LEPENC" SH. A. PRISHTINË

#### 1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullës ZRRUK - R 02/U&K.

#### 2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për aplikim nga NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë me rastin e faturimit të shërbimeve të furnizimit me uji të pa trajtuar me shumicë, për dy ujësjellës regional, dhe atë për; KUR "Mitrovica" Sh. A. Mitrovicë dhe KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë për njësinë e Drenasit.

### 3. Lista e Tarifave të Shërbimit

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë. për konsumatorët e vet do të aplikojë Tarifat e Shërbimit të ujit me shumicë të pa trajtuar gjatë vitit 2014 ashtu siç janë në Tabelën e më poshtme:

Numri rendor	Shfrytëzuesit e ujit me shumicë të pa trajtuar	Njësia matëse	Tarifa
1	KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë për Drenas	€/m <sup>3</sup>	0,0455
2	KUR "Mitrovica" Sh. A. Mitrovicë	€/m <sup>3</sup>	0,0184

### 4. Afati

Tarifat e përcaktuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të jenë të zbatueshme për periudhën **1 janar 2014 deri më 31 dhjetor 2014**. ZRRUK mund t'i bëjë korrigjimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të tarifave në bazë të kërkesës së NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë, në pajtim me nenin 16 të Rregullës ZRRUK- R 02/U&K.

### 5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë duhet të njoftojë Kompanitë e Ujësjesve Regional të cilat i furnizon me ujë të patrajtuar me shumicë me Tarifa të Shërbimit të përcaktuara nga ZRRUM, sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, me rastin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose tua dërgojë të njëjtave kopjen e saj me faturën e radhës.

### 6. Apelet

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A., ka të drejtë të apelojë në afat prej 15 ditëve të punës, në rast mospajtimi me këtë UTSH-ë tek Komisioni për Shqyrtim që themelohet konform nenit 34. Komisioni shqyrtues, pika 34.1., Ligji Nr. 03/L-086 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjes dhe Kanalizimit, të datës 15 qershor 2008.

### 7. Gjuha Zyrtare e Urdhrit të Tarifave për Shërbime

Kjo Urdhëresë për Tarifa të Shërbimit nxjerrët dhe publikohet në dy (2) versione të shkruara të gjuhëve zyrtare që përdoren në Kosovë dhe Gjuhen Angleze.

Në rast të mospërputhjeve në mes të versioneve, do të mbizotërojë versioni i shkruar në gjuhën Shqipe.

.....

Raif Preteni  
Drejtor i ZRRUK-ut